

BASHKIA KOLONJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti: Bashkia Kolonjë

Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 23173 ; 08122225 ; 2232
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com
Faqja e Internetit	http://www.kolonja.gov.al

2.Dhënie me qira, me konkurim publik, të tokës në pronësi të Bashkisë Kolonjë për Njësinë Administrative Qendër Erseke, fshati Starje,Kolonjë,Qarku Korçë me nr.pasurie 120/9, Zona Kadastrale 3510,Rrethi Kolonjë,lloji pa frut, me sipërfaqe 3.2964 ha.

3.Qëllimi i dhënies me qira të pasurisë nr. 120/9, Zona Kadastrale 3510, fshati Starje, Kolonjë, Qarku Korçë është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.

4.Konkurrimi do të zhvillohet më datë:06.04.2023, ora 11:00,në Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.

5.Çmimi dysHEME i qirasë, është 27,000 (njëzeteshtatë mijë) lekë/ha në një vit kalendarik.

6.Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 20 (njëzet) vjet.

7.Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :

- a) Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë,qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit;
- b) Plan biznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë;
 - identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen,
 - përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit
- analiza e detajuar e afatit kohor, që do të duhet për të realizuar projektin investues dhe treguesit që do të realizohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 1/4 e afatit të kontratës të cilët duhet të ruhen, deri në fund të afatit të kontratës si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij
- niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.
- c) Çertifikatën e regjistrimit dhe Çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB
- d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore,ose deklaratë

- e) Vetëdeklarim se subjekti ofertues dhe administratori nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces/e gjyqësor/e që lidhet/n me aktivitetin.
 - f) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, ose deklaratë.
 - g) Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore të Bashkisë Kolonjë, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore të kësaj bashkie.
 - h) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2022 dhe për vitin e fundit 2023 (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
 - i) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues
 - j) Afatin e përdorimit të tokës objekt qiramarrje.
8. Ofertat paraqiten në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
9. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- | | |
|---------------------------------------|---------|
| a) Niveli i Investimit | 35 pikë |
| b) Niveli i Punësimit | 35 pikë |
| c) Oferta e Detyrimit Mujor të Qirasë | 30 pikë |
10. Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 5 (pesë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkurruesit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.
11. Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 06.04.2023, para orës 11:00.